



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCËN SHKENCORE

Integrimi i gjuhës së shenjave në kontekstet sociale, arsimore, teknologjike dhe mediatike: rritja e ndërgjegjësimit dhe pasurimi i komunikimit për dhe me komunitetin e personave që nuk dëgjojnë

29 janar 2026

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

TIRANË

Në kuadër të projektit "Zhvillimi i kërkimit në gjuhën e shenjave shqipe: nga dokumentimi dhe pasurimi i fjalorit në analizën sociolinguistike të komunikimit të personave që nuk dëgjojnë" financuar nga AKKSHI, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që Nuk Dëgjojnë (ANAD), organizojnë në 29 Janar 2026 Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë:

Integrimi i gjuhës së shenjave në kontekstet sociale, arsimore, teknologjike dhe mediatike: rritja e ndërgjegjësimit dhe pasurimi i komunikimit për dhe me komunitetin e personave që nuk dëgjojnë

Kush mund të marrë pjesë?

Ftojme studiues, akademikë e profesionistë të fushës së komunikimit/gjuhës së shenjave të marrin pjesë në konferencën ndërkombëtare që do të organizohet në janar 2026, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Qëllimi i këtij eventi është shkëmbimi i rezultateve më të fundit në kërkimin e gjuhës së shenjave shqipe, duke përfshirë dokumentimin, pasurimin e fjalorit, analizën sociolinguistike, dhe aplikimet teknologjike në komunikim dhe edukim.

Temat kryesore të konferencës:

- Dokumentimi dhe pasurimi i fjalorit në gjuhën e shenjave
- Faktorë sociolinguistikë në zhvillimin e komunikimit të personave që nuk dëgjojnë

- Teknologjitë inovative në mbështetje të komunikimit dhe edukimit në komunitetin e personave që nuk dëgjojnë
- Ndërgjegjësimi shoqëror dhe sa më gjithpërfshirës në shoqërinë e sotme për bashkësinë e personave që nuk dëgjojnë dhe gjuhën e shenjave

Gjuhët e konferencës do të jenë shqip, gjuha e shenjave shqipe, anglisht dhe frengjisht. Pjesëmarrësit janë të lirë të dorëzojnë dhe prezantojnë punën e tyre në gjuhën shqipe, ose angleze, ose franceze.

Prezantimet mund të jenë kërkime shkencore, studime rastesh, ose reflektime teorike e praktike.

Ju lutemi dërgoni abstraktin tuaj deri më 12 janar 2026 në emailin sema.hysa@unitir.edu.al.

Konferenca do të mbahet në datën 29 **janar 2026**, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë, dhe punimet e saj do të zhvillohen fizikisht dhe online.

Pjesëmarrja është pa pagesë

Data të rëndësishme:

Afati i fundit për dorëzimin e abstraktit: 12 janar 2026

Njoftimi i pranimit të punimeve: 16 janar 2026

Njohja me programin përfundimtar: 23 janar 2026

Dorëzimi i kumtesave për botim: 6 shkurt 2026

Udhëzime për dorëzimin e abstraktit: Abstrakti duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze ose franceze, jo më i gjatë se 250 fjalë, përfshirë dhe fjalët kyçe. Abstrakti duhet të dorëzohet në formatin Word e të përmbajë Titullin, emrin/emrat e autorëve, institucionin përkatës nga vijnë, adresën zyrtare të email-it si edhe numrin ORCID individual.

Komiteti organizues:

Anida Kisi

Elona Toro

Irena Pata

Orges Selmani

Sema Hysa